***Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet të jenë të lëshuara** nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. *(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë perkatesisht Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

Nëse ofertuesi do të paraqitet si bashkim operatorësh, certifikatat duhet të jenë në përputhje me punimet e marra përsipër.

2.3.7 Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar "Apostile". Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, "Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja", duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

2.3.8. Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t'i përmbahen VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.3.9. Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, në përpyesjim dhe përputhje me punet e marra përpyes sipas marrevshjes së bashkepunitimit.

2.3.10. Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

Shënim: Operatorët ekonomikë/anëtarët e bashkimit/eve të operatorëve ekonomikë që do të ofertojnë për më tepër se një objekt prokurimi të shpallur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit 3 muajt e fundit brenda të njëjtit program apo programeve të ndryshme, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta për kualifikim (financiare dhe teknike) në mënyrë kumulative sa shuma e objekteve ku do të ofertojnë. Këtu do të përfshihen procedurat e deklaruara në Shtojcën 11 por edhe procedurat për të cilat operatorët ekonomikë/anëtarët e bashkimit/eve të operatorëve ekonomikë janë shpallur fitues apo vlerësuar në vend të parë për procedura të publikuara nga FSHZH.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 12

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Loti III – “Rikonstruktion rruge Unaza Lumalas - Melçan – Porodinë, Bashkia Korçë” me fond limit 62,644,465.8 lekë pa tvsh.

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;

c. Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;

e. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;

f. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;

g. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;

gj. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme për kualifikim.

2.2. Per kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit 2016, 2017 dhe 2018, duhet të mos jetë më e vogël se 50% e fondit limit të procedurës së prokurimit. *Per të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatimit Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.*

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të konfirmuara nga ky autoritet, në të cilat duhet të rezultojë se nuk ka dale me humbje të pakten në dy vite të njëpasnjëshme si dhe të shoqëruara me akt ekspertizën e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetësinë e informacionit te paraqitur. Ne rast deklarimi te rreme do te veprojë ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/et Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën :

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël se 50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- ose**
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është **në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Ngjashmëria e kontratave do të bazohet në madhësinë fizike, kompleksitetin, metodat/teknologjinë dhe/ose karakteristika të tjera të përshkruara në raportin teknik.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
 13. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 14. Kontratën/at e Sipërmarrjes
 15. Situacionin përfundimtar të objektit;
 16. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh
 17. Aktin e kolaudimit;
 18. Çertifikaten e marrjes në dorëzim.

Formulari i vlerësimit duhet te percaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes se punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj

- Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
 15. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 16. Lejen e ndërtimit
 17. Kontratën/at e Sipërmarrjes;

18. Situacionin përfundimtar të objektit;
19. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.
20. Akt kolaudimi objekti;
21. Çertifikaten e marrjes në dorezim të objektit;

Pika 2.3.1 gërma a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontraten e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit;

Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontrata baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
- Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën **40** punonjës **me kohë të plotë** pune për periudhën **Mars 2019 – Shtator 2019**, e vërtetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Mars 2019 – Shtator 2019**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Mars 2019 –Shtator 2019**, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

*Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhet për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **Mars 2019 – Shtator 2019**, tregon besueshmëri për autoritetin.*

2.3.2 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet

- a) Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga administratori i shoqërisë) stafin teknik të shoqërisë, si më poshtë:

Numri	Pozicioni dhe eksperiencia
1 (Nje)	Inxhinier Ndertimi /Drejtues Projekti i cili duhet te jete i punesuar prej 1 vite prane kompanise dhe te kete 10 vite eksperience pune .
1 (nje)	Inxhinier Ndërtimi / Pergjegjes Kantieri i cili duhet te jete pjese e stafit te kompanise prej 1 viti dhe te kete 5 vite eksperience pune.

1 (nje)	Inxhinier Hidroteknik / Pjese e stafit te kompanise prej 1 viti dhe 5 vite eksperience pune.
1 (nje)	Inxhinier Gjeodet/ Pjese e stafit te kompanise prej 1 viti dhe 5 vite eksperience pune.

Për stafin e mësipërm të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diploma/certifikata/CV
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën e përcaktuar si staf i shoqërisë

Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret dhe punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.3/a, jane te paangazhuar ne kontrata te tjera.

e) Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga kryqi i kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.
- 1 (një) punonjes (inxhinier mjedisi ose staf me kualifikim te ngjashëm) si "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” me eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diploma/certifikata/CV
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **Mars 2019 –Shtator 2019**.
- Deklaratë nga administratori

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merrem masa për ndërprerjen e kontratës dhe deri në propozimin në Agjencinë e Prokurimit Publik për marrje masash ndaj operatorëve ekonomikë.

f) Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1(një) mjek** në bazë të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 ”Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar),

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diplomë
- Urdhër Mjeku
- Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **Mars 2019 – Shtator 2019**.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje, në mbështetje të legjislacionit të sipërcituar.

- g) Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e licensimit (QKB) Kodi III.2. B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim të mbetjeve urbane”.

2.3.4 Operatorët ekonomike duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këto duhet të paraqesin licensën perkatese të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- | | | |
|------|-----|---|
| NP – | 1 A | Punime gjurmimi në tokë. |
| NP – | 4 C | Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale |
| NP – | 5 A | Punime nëntokesore, ura dhe vepra arti |

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- | | | |
|------|------|-----------------------------------|
| NS - | 6 A | Sinjalistika rrugore jo ndriçuese |
| NS - | 7 A | Barrierra dhe mbrojtje rrugore |
| NS - | 18 A | Punime topogjeodezike |

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

2.3.5 Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet dhe numri i tyre është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhet për të përmbushur kontratën.

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton	Cope	2	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10 - 20 ton	Cope	2	Në pronësi ose me qera
3	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 5 - 10 ton	Cope	2	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator me zinxhire	Cope	1	Në pronësi ose me qera
5	Eskavator me goma	Cope	1	Në pronësi ose me qera
6	Fadromë Kovë përpara dhe mbrapa	Cope	1	Në pronësi ose me qera
7	Vibrator	Cope	2	Në pronësi ose me qera
8	Freze asfalti		1	Në pronësi ose me qera
9	Greider		1	Në pronësi ose me qera
10	Gurëthyes, frontoje	Cope	1	Në pronësi ose me qera
11	Autobitumatriçe	Cope	1	Në pronësi ose me qera
12	Asfalto-shtruese	Cope	1	Në pronësi ose me qera
13	Rrul ngjeshes (kapaciteti jo më pak se 18 ton)	Cope	1	Në pronësi ose me qera
14	Rrul ngjeshes (kapaciteti jo më pak se 12 ton)	Cope	1	Në pronësi ose me qera
15	Rrul asfalti me gomë - gomë (Kapaciteti jo më pak se 8 ton)	Cope	1	Në pronësi ose me qera
126	Kompresor	Cope	1	Në pronësi ose me qera
17	Autobot uji	Cope	1	Në pronësi ose me qera
18	Gjenerator	cope	1	Në pronësi ose me qera

Eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojces nr.10 dhe dokumentacioni si me poshte:

- f) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të subjektit, duhet të paraqiten kontratat e shitblerjes dhe faturat tatimore të shitjes, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqiten kontratat e qerasë, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël), duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.

- g) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; vërtetimin e pagesës për taksat vjetore; siguracionin përkatës; ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerasë.
- h) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit dhe faturat tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerasë.
- i) Për fabrikën e asfaltit në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga Qendra Kombetare e Bisnesit dhe kontrata e qirasë (nëse është marrë me qira) ose kontratë furnizimi. Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht për skualifikim.
- j) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura në pikën 2.3.5 të Kapcitetit Teknik do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrata. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet për gjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e ketyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- h) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".**

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- BS OHSAS 18001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë* ose ekuivalent)

***Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet të jenë të lëshuara** nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë perkatesisht Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes*).

Nëse ofertuesi do të paraqitet si bashkim operatorësh, certifikatat duhet të jenë në përputhje me punimet e marra përsipër.

2.3.7 Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuar "Apostile". Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, "Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja", duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrtarë respektive nga vendi i origjinës.

2.3.8. Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t'i përmbahen VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.3.9. Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokura e posaçme. Çdo anëtar i grupit, duhet të dorëzojë dokumentat e kerkuara, në perpjestim dhe perputhje me punet e marra perisiper sipas marrevshjes se bashkepunimit.

2.3.10. Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënktraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala "periudhë" nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

Shënim: Operatorët ekonomikë/anëtarët e bashkimit/eve të operatorëve ekonomikë që do të ofertojnë për më tepër se një objekt prokurimi të shpallur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit 3 muajt e fundit brenda të njëjtit program apo programeve të ndryshme, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta për kualifikim (financiare dhe teknike) në mënyrë kumulative sa shuma e objekteve ku do të ofertojnë. Këtu do të përfshihen procedurat e deklaruara në Shtojcën 11 por edhe procedurat për të cilat operatorët ekonomikë/anëtarët e bashkimit/eve të operatorëve ekonomikë janë shpallur fitues apo vlerësuar në vend të parë për procedura të publikuara nga FSHZH.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Projekti i plote për çdo lot, përfshirë specifikimet teknike, janë ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit, bashkëngjitur dokumentave të tenderit.

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Jepet në sistemin elektronik të prokurimit, bashkëngjitur dokumentave të tenderit.

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Preventivi i punimeve për çdo lot jepet në sistemin elektronik të prokurimit, bashkëngjitur dokumentave të tenderit.

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e*

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke

përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkonsulentit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkonsulentin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkonsulentin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetëse ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të

projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

- 17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

